

**VENDIM**  
**Nr.289, datë 16.4.2004**

**PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË VLORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 "Për ujitjen dhe kullimin", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Vlorës, i cili financohet nga Buxheti i Shtetit.

2. Zona e shërbimit të kullimit të këtij bordi përbëhet nga:

a) zona e fushës së Myzeqesë (VLK-1,2,3), që kullon 6650 ha, nga të cilat me ngritje mekanike me hidrovor 5 550 ha dhe me rrjedhje të lirë 11 00 ha;

b) zona e fushës Llakatund-Armen (VLK-4,5), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 2800 ha;

c) zona e fushës Dukat-Tragjas (VLK-6), që kullon një sipërfaqe 1800 ha, nga e cila 400 ha kullon me ngritje mekanike me hidrovor;

ç) zona e fushës së lumit Shushicë nga Drashovica deri në Kallarat (VLK-7), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 4010 ha;

d) zona e fushës Sevaster-Shkozë-Dushkarat-Karbunarë-Romes (VLK-8), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 1000 ha;

dh) zona e fushës së Petes, Harvalasë, Peshkëpi-Vllahisë, Trevllazër-Cergovisë (VLK-9), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 1750 ha;

e) zona e fushës së Bregut, Qeparo-Himarë-Vuno-Pilur (VLK-10), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 420 ha;

ë) pendët mbrojtëse nga përmytjet e detit, të lumenjve dhe ato bregdetare përfshi dhe argjinaturën kufizuese të liqenit të Nartës, si dhe të kanaleve të ujërave të larta;

f) sistemi i mbrojtjes së tokave nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve.

3. Këshilli i përfaqësuesve të bordit të përbëhet nga:

a) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit;

b) 3 (tre) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

c) 3 (tre) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

ç) 2 (dy) përfaqësues të bashkive, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

d) 1 (një) përfaqësues i këshillit të qarkut;

dh) 1 (një) përfaqësues i biznesit, me veprimtari, brenda zonës së shërbimit të kullimit.

4. Anëtarët e këshillit të përfaqësuesve të shpërblehen, çdo muaj, me 5000 (pesë mijë) lekë.

5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.

6. Ngarkohet Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**